



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË**

---

**Kom.dh.shk.II.nr.1450/2022**

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË**, Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija - Ymeri, në çështjen juridike të kreditorit NTSH “K...”, me seli në Fushë Kosovë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Sh.K, avokat nga Prishtina, kundër debitorit “K...” sh.p.k, me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbarrimorë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshme PPP.nr.1433/21 të datës 31.03.2022, me datë 27.09.2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**HUDHET** si e palejuar ankesa e kreditorit NTSH “K...”, me seli në Fushë Kosovë, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshme PPP.nr.1433/21 të datës 31.03.2022.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1433/21 të datës 31.03.2022 në piken I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit K... sh.p.k., me seli në Prishtinë, ashtu që e ka shfuqizuar urdhërin për lejimin e përmbarrimit P.nr.1583/19 të datës 21.06.2019 për shumën prej 2,128.86€. ndërsa në piken II të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit K... sh.p.k., me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbarrimit P.nr.1583/19 i datës 21.06.2019 për shumën prej 70,606.74€. Në piken III të dispozitivit ka vendosur së nëse debitorit ushtron ankesë kundër këtij aktvendimi, debitori urdhërohet që në afatin prej 7 ditësh nga dita e ushtrimit të ankesës të paguaj garancionit në shumën prej 70,606.74€. Dhe në piken IV të dispozitivit ka vendosur që nëse debitori dështon të paguaj garancionin brenda afatit ligjor, ankesa kundër këtij aktvendimi do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

Kundër këtij aktvendimi, kreditori në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit dhe ta ndryshoje aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.1433/21 të datës 31.03.2022 në piken I të tij dhe atë pjesërisht vetëm sa i përket shfuqizimit të Urdhrit për lejimin e përmbarrimit për shumën prej 2,128.86€.

Përgjigje në ankese nuk ka.

Gjykata Komerciale si gjykatë e shkallës së dytë, pas ekzaminimit të aktvendimit të ankimuar në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të LPK-së dhe vlerësimit të shkresave tjera lëndore, ka gjetur se:

### **Ankesa është e palejuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se lënda në fjalë sipas ankesës së ushtruar nga kreditori përmes të autorizuarit të tij në Gjykatën Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë është pranuar më datën 20.04.2022. Para se kjo gjykatë të shqyrtonte dhe të vendoste në mënyrë meritore lidhur me ankesën e kreditorit, kreditori përmes të autorizuarit të tij më parashtrësën e datës 29.07.2022, Gjykatën Komerciale-Dhomën e Shkallës së Dytë e ka njoftuar se ka tërhequr ankesën të cilën e kishte paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1433/21, dt.31.03.2022, me arsyetim se palët lidhur më çështjen në fjalë kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për pagesën e borxhit në shumën prej 2,128.86€.

Dhoma e Shkallës së Dytë pasi e shqyrtoi parashtrësën e kreditorit të paraqitur përmes të autorizuarit të tij gjeti se sipas nenit 186 paragrafi 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), parashihet se: *“Ankesa është e palejueshme po që se e ka paraqitur personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj, apo personi që ka hequr dorë nga e drejta e ankimit apo që e ka tërhequr ankesën e paraqitur, apo në qoftë se personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës”* ndërsa me dispozitën e nenit 196 të LPK-së, parashihet se: *“ Ankesën e vonuar, jo të plotë, apo jo të lejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë, me aktvendim, po që së nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç parashihet me nenin 186”*.

Në këtë rast Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të parashtrësës së kreditorit më të cilën qartë është deklaruar rreth tërheqjes së ankesës së ushtruar, kjo gjykatë në kuptim të dispozitës së nenit 177.2 të LPK-së ku theksohet se *“ Deri në momentin e dhënies së vendimit të gjykatës së shkallës së dytë pala mund ta tërheqë ankesën e paraqitur”* prandaj kjo gjykate gjeti se ankesa e paraqitur nga kreditori është e palejuar, dhe si e tillë duhet hedhur poshtë.

Andaj, Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kuptim të dispozitës së nenit 186 paragrafi 3 i LPK-së, gjeti se ankesa e paraqitur nga kreditori është e palejuar, dhe si e tillë në mbështetje të nenit 196 të të njëjtit ligj, duhet hedhur poshtë.

Nga sa u tha me sipër, Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në pajtim me nenin 186 paragrafi 3, 195 paragrafi 1 pika (a) e lidhur me nenin 196 të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË,  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
Kom.dh.shk.II.nr.1450/22, data 27.09.2022**

**Gjyqtarja  
Franciska Zhitija -Ymeri**